




Pranuar / Dorezuar Prisitur / Prisuto Received / Delivered	22-04	2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org / Ustod	SKM/SHK	1953/2021		Sasia Kolicina Quantity
				113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.221/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1596/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.159/2019 të datës 04.03.2019 të parashtruar nga ankuesi [] me adrese banimi në fshatin "Graboc i Poshtëm", në Fushe Kosovë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", kundër organit të punësimit-Komuna e Fushë Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.04.2021, mori këtë

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.159/2019 e datës 04.03.2019, e parashtruar nga ankuesi []
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.156 i datës 19.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Fushë Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi, [] i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës, sipas Akt emërimit të datës 21.07.2016, në pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 2", në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me datë 14.02.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Fushë Kosovës ku ka kërkuar ndryshimin e koeficientit nga 5.5 në koeficientin 6.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Fushë Kosovës me vendimin me Nr.156 të datës 19.02.2019, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar me arsyetimin se ankuesi fillimisht nuk ka bërë kërkesë në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.156 të datës 19.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Fushë Kosovës, më datë 04.03.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1115/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 05.03.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Fushë Kosovës. Më datë 19.03.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Fushë Kosovës bashkë me provat e bashkangjitura faqe 1/7.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.06.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 01.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1596/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.06.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 04.03.2019.

Administrimi i Provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1115/2019 e datës 04.03.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 01.01.2012; Vendimi me Nr.156 i datës 19.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesa me nr.1135 i datës 27.11.2017 për Kryetarin e Komunës; Kërkesa me nr.80 i datës 22.11.2013; Lista e pagave e muajit janar 2019; Vendimi i datës 16.01.2019 me numër protokolli 239/2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 14.02.2019 me nr.161 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Fushë Kosovës; Vendimi me nr.38 i datës 18.01.2019 për formimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Fushë Kosovë; Përgjigje në shkresën nr.7775/2018 i datës 19.12.2018; Akt emërimi i datës 21.07.2016 me numër 879; Fletëkthesa e datës 12.03. 2019 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 19.03.2019 me numër protokolli 1573/2019 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/7; Njoftimin e datës 17.06.2019 për ankuesin; Aktgjykimin A.nr.1596/19 i datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji i Këshillit, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e paraqitura, konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesi me datë 01.01.2012 ka nënshkruar akt emërimin në pozitën e punës "Nëpunës i Asistencës Sociale", si dhe me datë 21.07.2016 ankuesi ka nënshkruar akt emërimin me numër Nr.879 në pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 2", rrjedhimisht nga kjo ankuesi është vënë në dijeni për të drejtat dhe detyrimet që lindin nga marrëdhënia e punës, e po ashtu edhe me të drejtën e realizimit të pagës. Kolegji nga provat e lëndës konstaton se ankuesi me datë 21.07.2016 ka nënshkruar Akt emërimin Nr.879 në pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 2", rrjedhimisht nga kjo Kolegji konstaton se ankuesi Kërkesën me numër Nr.79 të datës 22.11.2013, Kërkesën me numër Nr.1135 të datës 27.11.2017 si dhe Kërkesën Nr.161 të datës 14.02.2019 i ka parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: „Ankesa



duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", si dhe jashtë afatit të paraparë me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës". Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se momenti kur ankuesit i ka filluar t'i rrjedh afati për ankimim, është momenti kur ankuesit i ka dal paga në xhirollogarinë e tij në muajin shkurt 2012, respektivisht në muajin shtator 2016 për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 2".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Fushë Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 156 të datës 19.02.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike sepse nuk ka arritur të shqyrtojë afatshmërinë e ankesës së ankuesit sepse ankuesi më datë 01.01.2012 ka nënshkruar Akt emërimin për pozitën "Nëpunës i Asistencës Sociale", dhe nga ky moment ankuesi ka qenë në dizeni lidhur me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës dhe për çdo pakënaqësi lidhur me këtë proces është dashur që të parashtrorjë ankesë në pajtim me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", dhe me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës".

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.1596/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr. 221/2021.

Sabile AVDYLI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetarë e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi;
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Menaxheres së Personelit në Komunën e Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.